



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 688, Datë 06.04.2020

“Për shtyrjen e afateve të gjitha procedurave hetimore në proces nga Autoriteti i Konkurrencës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 06.04.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për shtyrjen e afateve të gjitha procedurave hetimore në proces nga Autoriteti i Konkurrencës.

Baza Ligjore: Neni 4 dhe 9, Neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 41, 42, 43 dhe 44 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Urdhri nr. 132, datë 08.03.2020, i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura”, në kuadër të masave parandaluese për përhapjen e COVID-19.

Komisioni i Konkurrencës, në vijim të rrethanave të krijuara për shkak të masave parandaluese të ndërmarra nga Qeveria për shkak të COVID-19, afati për dorëzimin e informacionit do të shtyhet deri në një vendim të dytë.

VËREN SE:

1. Për shkak të situatës epidemike të krijuar nga përhapja e epidemisë së COVID-19 dhe vështirësisë së krijuar në mbledhjen e informacionit dhe procedurave të hetimit nga zbatimi i masave të ndërmarra nga Qeveria nëpërmjet Urdhrit nr. 132, datë 08.03.2020, i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura”, në kuadër të masave parandaluese për përhapjen e COVID-19.
2. Për të mos penguar mbledhjen e informacionit sasior dhe cilësor si nga ndërmarrjet private ashtu edhe nga institucionet shtetërore, Komisioni i Konkurrencës e ka vlerësuar si të

arsyeshme që periudhat hetimore të shtyhen deri në një vendim i dytë që do të jetë në vijim të masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së COVID-19.

3. Ky vendim ka për efekt afatet kohore të procedurave hetimore dhe nuk pengon vijimin e punës nga Autoriteti i Konkurrencës dhe as inspektimet e befasishme apo analizat në vlerësimin e informacioneve të grumbulluara.
4. Procedurat e vlerësimit të përqendrimeve nuk ndryshojnë në afatet e shqyrtimit të tyre.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 41, 42, 43 dhe 44 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Urdhrit nr. 132, datë 08.03.2020, i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura”,

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatave të gjitha procedurave hetimore në proces nga Autoriteti i Konkurrencës.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për vendimin.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS